VENDIM
Nr. 180, datë 25.3.2021

PËR HAPJEN E PIKËS SË KALIMIT KUFITAR NË AEROPORTIN E KUKËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 71/2016, "Për kontrollin kufitar", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e pikës së kalimit kufitar në aeroportin e Kukësit për qarkullimin ndërkufitar ajror të shtetasve.
2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe